



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË
ZYRËS SË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN
2020

Prishtinë, qershor 2021

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Shënim

Ky Raport i auditimit është gjeneruar për herë të parë përmes platformës elektronike për menaxhimin e auditimit (SITA). Po ashtu, këtë vit, përdoret shablloni i ri i Raportit të auditimit, sipas metodologjisë së përditësuar për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Raporti përfshinë për herë të parë edhe konkluzionin e veçantë për pajtueshmëri.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm që aplikimi i të gjitha këtyre risive njëkohësisht, në rrethana të pazakonshme të pandemisë, mund të rezultojë me ndonjë lëshim të paqëllimshëm teknik, për çka ju kërkohet falje paraprakisht dhe ju falënderojmë për mirëkuptim!

Për: Fehmi Mehmeti, U.D Sekretari i Përgjithshëm

Adresa: Ndërtesa e Kuvendit Sheshi "Nëna Terezë" , Prishtinë, Republika e Kosovës

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës (ZPRK), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të ZPRK kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

U.D Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, U.D Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

U.D Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës me kriteret e përcaktuara

te auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.


Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit kemi vërejtur se procesi i menaxhimit financiar dhe kontrollit ishte përcjellë me disa mangësi në fusha të caktuara, si: ekzekutimi i shpenzimeve jashtë vlerave dhe afateve të kontraktuara, nënshkrimi i aneks kontratës mbi limitin e lejuar të kontratës bazë dhe ndarja e subvencioneve duke mos zbatuar rregulloren për financimin e projekteve të OJQ-ve. Mangësitë e identifikuara janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve (siç janë paraqitur më poshtë në Grafikon 1) dhe rekomandimeve.

Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Grafiku 1. Lloji i gjetjeve sipas kategorive ekonomike⁴



Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. [Për detajet shih kapitullin 4].

2.1 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.1.1 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe komunalitë në vitin 2020 ishte 1,170,268€, prej tyre ishin shpenzuar 1,008,728€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shpenzimet e udhëtimeve zyrtare, furnizime për zyrë, shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse dhe shërbimet komunale. Në këtë kategori kemi testuar 50 mostra për teste substanciale në vlerë 433,775€ si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A1 - Lidhja e aneks kontratës në vlerë 100% të kontratës bazë

Gjetja Bazuar në UOPP – Neni 61.25 asnjë ndryshim kontratë nuk do ta shtojë çmimin total të kontratës me më shumë se 10 % të çmimit fillestar të kontratës me aprovim nga Zyrtari Kryesor Administrativ.

ZP kishte kontratë për "Shërbime të sigurimit të automjeteve, në vlerë 8,356€, prej datës 24.05.2019 deri më datën 23.05.2020. Pastaj me datën 20.07.2020 është nënshkruar aneks kontratë me vlerë 8,356€ me të njëjtin OE me vlerë 100 % të çmimit fillestar të kontratës.

Nënshkrimi i aneks kontratës në vlerën 100% pa zhvillim të procedurave, ka ndodhur për arsye se para përfundimit të kontratës bazë, procedura e hapur e prokurimit e shpallur me datën 09.07.2020 ishte anuluar për shkak të mungesës së ofertave dhe nuk është vazhduar prapë me ritenderim si dhe për arsye që të mos ngecin në ofrimin e shërbimeve të transportit për kabinetin dhe administratën e ZPRK.

Ndikimi Nënshkrimi i aneks kontratës me vlerë më të lartë se ajo e lejuar, duke mos zbatuar procedurat e prokurimit, ndikon në zvogëlimin e konkurrencës dhe rrit rrezikun e pagesës së shërbimeve më të shtrenjta sesa çmimet aktuale të tregut.

Rekomandimi A1 Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj që nënshkrimi i aneks kontratës nuk duhet të nënshkruhet më shumë se 10 % e vlerës së kontratës, në të kundërtën duhet të bëhet përmes procesit të rregullt dhe transparent të prokurimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Pagesat përmes vendimeve gjyqësore-përmbarimore**Gjetja**

Bazuar në Rregullen Financiare Nr.01/2013/MF – Shpenzimi i Parave Publike Neni 26, pika 1 citon: asnjë detyrim që është rezultat i një dokumenti, marrëveshje apo aranzhimi nuk zbatohet nëse dokumenti, marrëveshja ose aranzhimi i këtillë që themelon apo rezulton në lindjen e këtij detyrimi është përpiluar, pranuar apo lidhur në një mënyrë që nuk i përmbush kushtet e përcaktuara në dispozita e LMFPP. Më tutje, Neni 2. Për procedim të pagesës kërkohen këto dokumente, pika 2.2 Kopja e kontratës që është nënshkruar nga zyrtari përgjegjës i prokurimit si kopje autentike e origjinalit.

Përkundër përfundimit të kontratës për shërbime postare, ZPRK kishte vazhduar me marrjen e shërbimeve pa procedura të ripërtrirjes së kontratës. Për kompensimin e këtyre shërbimeve, përmes përmbaruesit privat nga Thesari ishte kryer pagesë direkte në vlerë 3,988€. Prej kësaj vlere, borxhi kryesor ishte 3,311€ ndërsa 677€ ishin shpenzime për shërbime gjyqësore dhe të përmbarimit.

Kjo ka ndodhur për shkak të kërkesave për shërbime postare të domosdoshme edhe pse për këto shërbime kishte përfunduar vlera dhe afati i kontratës.

Ndikimi

Hyrja në detyrime financiare në mungesë të kontratës apo të një baze të qartë ligjore, ndikon në shpenzimin e buxhetit për qëllime tjera të pa planifikuara me buxhetin e vitit aktual si dhe shpenzime shtesë në emër të shpenzimeve gjyqësore dhe të përmbarimit.

Rekomandimi A2

Sekretari i Përgjithshëm, duhet të bëjë me kohë planifikimin e procedurave të prokurimit dhe lidhjen e kontratave për këto shërbime të domosdoshme, për të parandaluar pagesat e parregullta dhe të pa kontraktuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.2 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 270,000€, prej tyre në vitin 2020 ishin shpenzuar 269,951€. Ato kanë të bëjnë me projekte të ndryshme varësisht prej kërkesave nga personat fizik dhe juridik. Ne kemi testuar tetë (8) mostra për teste substanciale në vlerë 41,812€ si dhe pesë (5) mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A3 - Ndarja e subvencioneve ndaj OJQ-ve në mungesë të shpalljes për thirrje publike

Gjetja

Sipas Rregullores MF-Nr.04/2017, mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neni 12, përcakton që çdo mbështetje financiare për OJQ-të duhet të shpallet përmes thirrjes publike, e cila duhet të publikohet në ueb faqen e ofruesit të mbështetjes financiare. Në këtë rregullore, janë përcaktuar kriteret që duhet zbatuar nga të gjitha organizatat buxhetore të cilat financojnë projektet apo programet e OJQ-ve.

Në pesë (5) raste të testuara në vlerë 24,220€, Zyra e Presidentit kishte ndarë subvencione ndaj OJQ-ve të cilat kishin bërë kërkesë për financimin e projekteve të tyre. Për këto subvencione, nuk ishte bërë shpallje publike.

Kjo ka ndodhë pasi që procedura e dhënies ishte bërë bazuar në udhëzimin e brendshëm për procedurat e ndarjes së subvencioneve i cili nuk parasheh thirrje publike lidhur me mbështetjen financiare ndaj OJQ-ve.

Ndikimi

Mbështetja financiare e OJQ-ve pa thirrje publike ndikon në kufizimin e konkurrencës dhe përzgjedhjes së përfituesve.

Rekomandimi A3

Sekretari i Përgjithshëm, duhet të sigurojë që mbështetja financiare e OJQ-ve do të bëhet përmes thirrjes publike dhe kërkesave tjera të rregullores MF-Nr.04/2017, mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, lidhur me gjithë ciklin e ofrimit të mbështetjes financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.3 Shpenzimet për menaxhimin e pandemisë Covid-19

Buxheti për shpenzimet për menaxhimin e pandemisë Covid-19 ishte 36,000€, prej tyre në 2020 ishin shpenzuar 8,784€. Ato kanë të bëjnë kryesisht për furnizim me pajisje mbrojtëse kundër përhapjes së virusit COVID 19.

Çështja A4 - Ekzekutimi i pagesës jashtë kontratës

Gjetja Rregulla financiare Nr.1/2013, neni 25 pika 1 dhe 2 definojnë se para se të regjistrohet shpenzimi në SIMFK, dokumentacioni për pagesë dorëzohet te zyrtari çertifikues, i cili është përgjegjës që dokumentacioni të jetë i kompletuar, në të kundërtën zyrtari çertifikues nuk do ta çertifikoj dokumentacionin për pagesë.

Zyra e Presidentit në kontratën për "Furnizim me pajisje mbrojtëse kundër përhapjes së virusit COVID 19" kishte përmbushur vlerën e kontraktuar. Përkundër kësaj, ZPRK kishte pranuar furnizime dhe kishte ekzekutuar pagesën në vlerë 2,276€ përtej vlerës së kontraktuar, të cilat ishin me çmimin e njëjtë të kontratës së përmbushur.

Arsyeja e realizimit të furnizimeve dhe pagesës, ishte situata e pandemisë dhe nevoja për furnizime të shpejta kundër përhapjes me Covid-19.

Ndikimi Ekzekutimi i pagesave përtej kontratës rritë rrezikun e pagesave të pa rregullta.

Rekomandimi A4 Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj kontrolle efektive në mënyrë që asnjë pagesë të mos kryhet në mungesë të kontratës apo ndonjë bazë të qartë ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Burimet e fondeve	4,072,865	2,487,791	2,326,202	3,693,416	3,256,583
Grante Qeveritare – Buxheti	4,072,865	2,487,532	2,326,202	3,693,416	3,256,583
Donacionet e jashtme	0	259	0	0	0

Buxheti përfundimtar është më i ulët se buxheti fillestar për 1,585,074€. Fillimisht ishte zvogëluar me rishikim të buxhetit për vlerën 692,744€, ndërsa me shkurtime buxhetore sipas vendimeve të Qeverisë për vlerën 892,330€.

Në vitin 2020 ZPRK ka shpenzuar 94% të buxhetit përfundimtar ose 2,326,202€, me një rritje 13% në krahasim me vitin 2019. Sidoqoftë, zbatimi i buxhetit mbetet në një nivel të kënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	4,072,865	2,487,790	2,326,201	3,693,416	3,256,582
Pagat dhe mëditjet	1,099,565	1,047,522	1,047,522	1,099,103	1,012,301
Mallrat dhe shërbimet	2,181,600	1,166,312	1,005,325	2,321,867	1,961,785
Komunalitë	6,700	3,956	3,403	3,836	4,093
Subvencionet dhe transferet	270,000	270,000	269,951	268,610	264,800
Investimet Kapitale	515,000	0	0	0	13,603

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:


- Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 52,043€. Ky zvogëlim ishte si rezultat i largimit të stafit të kabinetit të ish Presidentit nga lista e pagave. Vlera e shpenzuar në këtë kategori ishte 1,047,522€;

- Buxheti final për mallra dhe shërbime në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 1,015,288€. Fillimisht si rezultat i ndryshim dhe plotësimit të Ligjit nr.07/l-001 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020 është bërë zvogëlimi i buxhetit për 310,000€. Pastaj me Vendim të Sekretarit të ZPRK nr.79/2020 është zvogëluar buxheti për transfer


në vlerë 89,000€ (39,000€ në investime kapitale dhe 50,000€ në subvencione dhe transfere), ndërsa me vendim të Qeverisë nr.09/50 për kursime në fund të vitit 2020, ishte zvogëluar për 616,288€;

- Buxheti final për komunalitet në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për vlerën 2,744€. Ky zvogëlim ishte bërë me rishikim të buxhetit;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere në raport me buxhetin fillestar nuk kishte ndryshime. Megjithatë, me rishikim të buxhetit ishte zvogëluar për vlerën 50,000€, ndërsa me të njëjtën vlerë ishte rritur me vendim të sekretarit për transferë nga kategoria mallra dhe shërbime; dhe
- Buxheti final për investime kapitale në raport me atë fillestar ishte zvogëluar për vlerën 515,000€. Me rishikim të buxhetit ishte zvogëluar për 330,000€ dhe duke pas parasysh që gjatë vitit 2020 nuk kishte shpenzim për projektet e planifikuara, në fund vitit buxheti i pa shpenzuar nga kjo kategori ishte deklaruar për kursime buxhetore.

Grafiku 2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2018-2020



Grafiku 3. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2020



4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2019 të ZPRK ka rezultuar në pesë (5) rekomandime kryesore. OB kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Po ashtu, kishte dorëzuar Raportin e Progresit mbi zbatimin e rekomandimeve sipas kërkesave të dalura nga Rregullorja e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit.

Deri në fund të vitit 2020, katër (4) rekomandime janë zbatuar ndërsa një (1) rekomandim është mbyllur, siç është paraqitur më poshtë në Grafikon 4. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shih tabelën e rekomandimeve Nr.3.

Grafiku 4. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 3 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Pagat dhe mëditjet	Rekomandimi B1 Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj se angazhimi i nëpunësve me marrëveshje për shërbime të veçanta, të bëhet vetëm pasi janë vlerësuar dhe arsyetuar nevojat për shërbimet specifike të tyre dhe, më pas, përmes zhvillimit të procedurave të kërkuara ligjore, si dhe duke respektuar afatin e lejuar ligjor për kohëzgjatjen e tyre.	Menaxhmenti ka ndërmarrë veprime duke përmbyllur të gjitha marrëveshjet me shërbime të veçanta.	I zbatuar
2.	Mallrat dhe shërbimet pa	Rekomandimi A1 Sekretari i Përgjithshëm, duhet të siguroj se të gjitha shpenzimet	Menaxhmenti ka marrë veprime,	I zbatuar

	Komunalitë	planifikohen dhe realizohen nga kategoritë adekuate sipas natyrës së shpenzimit, bazuar në planin kontabël të aprovuar nga MF.	pasi e njëjta gjendje nuk është hasur gjatë vitit aktual.	
3.	Subvencionet dhe transferet	Rekomandimi A2 Sekretari i Përgjithshëm, të siguroj forcimin e kontrolleve në fushën e monitorimit të përfituesve të subvencioneve, për sigurimin e dëshmimeve përkatëse lidhur me shfrytëzimin e mjeteve nga përfituesit, ndërsa për mjetet e paarsyetuara, të sigurohet se merren masat e duhura të përcaktuara në vendim.	Raportet kthyesë ishin sjellë nga përfituesit pas përfundimit të auditimit tonë në teren.	I zbatuar
4.	Pasuritë	Rekomandimi A3 Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj se me rastin e pranimit të pasurive jo financiare caktohet komisioni i pranimit prej jo më pak se tre anëtarë dhe çdo pasuri jo financiare pranohet nga komisioni i caktuar.	Menaxhmenti ka marrë veprime, ka caktuar komisione të pranimit me rastin e furnizimit me pasuri jo financiare.	I zbatuar
5.	Auditimi i Brendshëm	Rekomandimi B2 Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurohet që NJAB është fokusuar në realizimin e planit të punës duke ndërmarrë veprime aktive në mënyrë që devijimet (ngecjet në plan) të adresohen në kohën e duhur.	NJAB nuk ka aritur ta përmbush planin e punës për shkak të rrethanave të krijuara nga pandemia.	Nuk është i aplikueshëm më

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020
1.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj që nënshkrimi i aneks kontratës nuk duhet të nënshkruhet më shumë se 10 % e vlerës së kontratës, në të kundërtën duhet të bëhet përmes procesit të rregullt dhe transparent të prokurimit.
2.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Sekretari duhet të bëj me kohë planifikimin e procedurave të prokurimit dhe lidhjen e kontratave për këto shërbime të domosdoshme, për të parandaluar pagesat e parregullta dhe të pa kontraktuara.
3.	Subvencionet dhe transferet	Sekretari i Përgjithshëm, duhet të sigurojë që mbështetja financiare e OJQ-ve do të bëhet përmes thirrjes publike dhe kërkesave tjera të rregullores MF-Nr.04/2017, mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, lidhur me gjithë ciklin e ofrimit të mbështetjes financiare.
4.	Covid - 19	Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj kontrolle efektive në mënyrë që asnjë pagesë të mos kryhet në mungesë të kontratës apo ndonjë baze të qartë ligjore.

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm



Qerkin Morina, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Shkelqim Xhema, Udhëheqës i Auditimit



Shemsije Llugiqi, Udhëheqëse e ekipit



Refiqe Morina, Anëtare e ekipit



Leonora Hasani, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
ZYRA E PRESIDENTIT - BUREAU PRESIDENTIAL - OFFICE OF THE PRESIDENT

Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No. 644 Date / Datum / Date: 25, 06, 21

PRISHTINE/IA



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE

DATE PRANUAR DORËZUAR: 25.06.2021
DATE PRILMARRJE POSTALJEN: 25.06.2021
DATE RECEIVED / ADMITTED:

Njësia Org. / Org. Unit	Shif. klasif. / Klassif. Kod / Class. Code	Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No.	Nr. i faqeve / Br. Stranica / No. Pages
<u>05</u>	<u>47</u>	<u>988</u>	<u>1</u>



REPUBLIKA E KOSOVËS – ZYRA E PRESIDENTES
REPUBLIC OF KOSOVO – OFFICE OF THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO – KANCELARIJA PREDSEDNICE

ZYRA E SEKRETARIT - OFFICE OF THE SECRETARY - KANCELARIJA SEKRETARA

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2020 dhe për zbatimin e rekomandimeve


Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Zyrës së Presidentit të Kosovës, për vitin 2020 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit.
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

U.D i Sekretarit Fehmi Mehmeti, ZPRK


Data: 25 qershor 2021,

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet.⁷ Ky opinion duhet të veçohet nga opinioni nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, d.m.th. opinionin mund të modifikohet në lidhje me çështjen(t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinionin i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri.

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit:

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikrat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikrat e mira.